Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.08.2019, mori këtë

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SHTATORES SË VEPRIMTARIT

ADEM DEMAÇI

I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e shtatores së veprimtarit Adem Demaçi, në sheshin "Adem Demaçi", në Prishtinë.

II. Lokacioni për vendosjen e shtatores së veprimtarit Adem Demaçi, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 7580-1, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë Shoqërore KK Prishtinë.

III. Ky vendim paraqet bazë për vendosjen e kësaj shtatoreje.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit dhe skicat e organizimit të hapësirës.

V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-187761/19, më 01.08.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së veprimtarit Adem Demaçi

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën nr. 04-016/01-179743/19, të dt. 24.07.2019, drejtuar Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës, nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për vendosjen e shtatores së veprimtarit Adem Demaçi.

Në këtë kërkesë drejtuar Kuvendit të kryeqytetit për vendosjen e shtatores, theksohet se paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është marrë *Vendimi nr. 02/59, të dt. 31.07.2018, për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi" në Prishtinë* dhe, sipas këtij Vendimi, është propozuar nga Komisioni që kjo shtatore të vendoset në këtë shesh. Është planifikuar që shtatorja të vendoset më 28 nëntor 2019.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e shtatores, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01 nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë hapësirë me përmbajtje publike. Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 7580-1, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë Shoqërore KK Prishtinë.

Vendosja e shtatores në fjalë është propozuar të bëhet në hapësirën brenda këtij sheshi, sipas propozimit të bashkëngjitur, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset shtatorja është sipërfaqe e gjelbëruar, meqë kjo zonë më herët ka shërbyer edhe si Parku i të martuarve, andaj gjatë vendosjes së shtatores duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit, drurëve dhe propozohet që shtatorja, së bashku me hapësirën përreth, të vendoset në madhësi, formë dhe material të përcaktuar sipas kërkesës së parashtruar.

Bashkëngjitur:
- Ortofoto e lokacionit,
- Skicat e organizimit të hapësirës dhe
- Kërkesa nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Lokacionit i propozuar për vendosjen e shtatores

Skicat e organizimit të hapësirës